



Datë: 21.05.2025

Numër Protokolli: 3386/2025

A.nr.601/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi- Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj -Demi anëtarë me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.601/2025 të datës 04.04.2025, të parashtruar nga ankuesja E.N, kundër organit të punësimit: Komuna e Klinës në çështjen juridik “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.601/2025 e datës 04.04.2025, e parashtruar nga ankuesja E.N.

A r s y e t i m

Ankuesja E.N (me tej referuar vetëm ankuese), më datë 04.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.601/2025, me pretendimet ankimore lidhur me konkursin RN00016714, të datës 13.02.2025, për Grup i Buxhetit dhe Financave, për pozitën “Zyrtar për Zotim e Mjeteve Buxhetore”, Profesionale 2, të zhvilluar nga Komuna e Klinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 10.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Komuna e Klinës, ndërsa kjo e fundit, më datë 17.04.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A.nr. 2247/2025 të datës 04.04.2025; drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër referencë RN00016714, i datës 13.02.2025; Kopje e letërnjoftimit për E.N; Kërkesën për përgjigjeje në ankesë e datës 10.04.2025, e dërguar përmes emailit nga R.K, për Xh.D; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 601/2025, e datës 17.04.2025; Lista e aplikantëve; Njoftimi me numër protokolli 111-7618/25, i datës 17.03.2025, i nxjerr nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Klinës; Njoftimi me numër protokolli 111-9687/25, i datës 07.04.2025 i nxjerr nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Klinës; Vendimi me numër protokolli 112-8308/25,

i datës 25.03.2025, i nxjerr nga Kryetari i Komunës së Klinës; Renditja përfundimtare e kandidateve e datës 07.04.2025; Formuari i Vlerësimit të Përgjithshëm të Esesë së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 02.04.2025, i datës 02.04.2025, sipas kodit CN2492; Formuari i Vlerësimit të Përgjithshëm të Esesë së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 02.04.2025, sipas kodit CN9894; Formuari i Vlerësimit të Përgjithshëm të Esesë së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 02.04.2025, sipas kodit CN3504; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin për Intervistë, i datës 07.04.2025. për kandidatin A.E, nga anëtari i komisionit B.H; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin për Intervistë, i datës 07.04.2025. për kandidatin A.E, nga anëtari i komisionit E.C; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin për Intervistë, i datës 07.04.2025. për kandidatin A.E, nga anëtari i komisionit A.B; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin për Intervistë, i datës 07.04.2025. për kandidatin A.E, nga anëtari i komisionit R.B; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin për Intervistë, i datës 07.04.2025. për kandidatin A.E, nga anëtari i komisionit K.R; Vendimi i datës 17.03.2025, i nxjerr nga Kryetari i Komunës së Deçanit; Vendimi me numër protokolli 112-39399 i datës 19.11.2024 i nxjerr nga Kryetari i Komunës së Klinës; Akt Emërimi me numër protokolli 02. Nr. 112-29261/2024, i datës 21.08.2024, për B.H; Akt Emërimi me numër protokolli 02. Nr. 112-29543, i datës 30.08.2024, për A.B; Vendimi me numër protokolli 01. Nr. 112-6706, i datës 07.03.2025, i nxjerr nga Kryetari i Komunës së Klinës; Diplomë e datës 26.10.2021, për A.E, e lëshuar nga Universiteti "Haxhi Zeka", Pejë; Kontratë e punës me kohë të pacaktuar e datës 03.01.2023; Pasqyra e Trustit, për A.E, për periudhën nga data 16.03.2022, deri me datën 24.02.2025; Diplomë e datës 12.03.2012, për E.N, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Pasqyra e Trustit, për E.N, për periudhën nga data 01.08.2002, deri me datën 25.02.2025; Certifikatë e vitit 2013, për E.N; Konfirmim i datës 28.12.2011; Pyetjet e hapura për Testim individual.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së ankesa e ankueses është e palejuar, **sepse**:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Komuna e Klinës, më datë 13.02.2025, ka shpallur konkursin me numër reference RN00016714 për emrin e grupit "Grupi i Buxhetit dhe Financave, pozita e punës " Zyrtar për Zotimin e Mjeteve Buxhetore " klasa Profesional 2, numri i kërkuar një (1) pozitë. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 14.02.2025 deri me 15.03.2025, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesja.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me të cilin është përcaktuar se:...12. *Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative..* si dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me të cilin shprehimisht parashihet se: Ankesa në procedurë pranimit. 1. *Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve dhe rrjedhimisht konstatoi se kandidati për pranimit në Shërbim Civil, në rast të pakënaqësive me procesin e rekrutimit ka të drejtë të parashtror ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, ndërsa, në rastin konkret ankesa është parashtruar rrjedhimisht në kohën e parashtrimit të ankesës së ankueses me datë 04.04.2025, nuk është përfunduar ende procedura e pranimit sipas konkursit me numër të referencës RN00016714 gjegjësisht sipas përgjegjës në ankesë nga Komuna e Klinës, del se Njoftimi për përzgjedhjen përfundimtare është bërë përmes Njoftimit me numër protokolli 02 Nr.111-9687/2025, me datën 07.04.2025, andaj mbi bazën e kësaj rezulton së ankesa e ankueses është e parakohshme, dhe si e tillë është e palejueshëm në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L 048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendoi si në dispozitivin e këtij vendimi

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendim

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr 601/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, E.N;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së